

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6775
E martë, 6 dhjetor 2022
çmimi 0.40

Sistemi i drejtësisë në Kosovë ka nevojë për reforma të mirëfillta

FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NDIHMËSADMINISTRATORJA PËR EVROPË DHE EUROAZI NË USAID, AMBASADORJA ERIN E. MCKEE DHE PRESIDENTJA VJOSA OSMANI KANË MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

MCKEE: NORMALIZIMI I RAPORTEVE KOSOVË - SERBI ME NJOHJEN NË QENDËR, MËNYRA MË E MIRË

FAQE 5



Ndihmësadministratorja për Evropë dhe Euroazi në USAID, ambasadorja Erin E. McKee, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, ka thënë se normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, me njohjen reciproke në qendër, është mënyra më e mirë për

përmirësim të raporteve mes fqinjëve. Ajo ka theksuar se USAID-i do të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën për zhvillimin e një gjyqësori të drejtë dhe të paanshëm, si dhe për zvogëlimin e nivelit të korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit

AKTUALE




RRETH 100 AUTOBUSË PRIVATË BLOKOJNË TË GJITHA UDHËKRYQET E SHKUPIT F. 2

BE-JA BËN PLAN PËR PENGIMIN E IMIGRANTËVE ILEGALË QË HYJNË NGA BALLKANI F. 3

LANSOHET PROTOKOLLI SHTETËROR PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE F. 5

EKONOMI



RËNIA E NDJESHME E RITJES EKONOMIKE NË KOSOVË, SFIDË PËR KONSUMATORËT DHE BIZNESET F. 8

HOTI: SERBIA BËHET PARTNERE KRYESORE TREGTARE E KOSOVËS NË RAJON F. 8

SPORT



BRAZILIA DHE KROACIA KUALIFIKOHEN NË ÇEREKFINALE TË KUPËS SË BOTËS F. 10



VETERANËT PARALAJMËROJNË PROTESTA NËSE NUK PËRFSHIHEN NË PAGËN MINIMALE

FAQE 3



BQK-ja: SEKTORI BANKAR ËSHTË I SIGURT, NUK KA NEVOJË PËR PANIK

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rreth 100 autobusë privatë bllokojnë të gjitha udhëkryqet e Shkupit

SHKUP, 5 DHJETOR - Rreth 100 autobusë të shoqatave të transportuesve privatë kanë bllokuar përsëri të hënën të gjitha udhëkryqet e Shkupit, duke shkaktuar kaos në rrugët e kryeqytetit të Maqedonisë së Veriut.

Transportuesit po kërkojnë që t'u paguhet borxhi i rreth dy milionë eurove, të cilin, siç thonë ata, ua ka Ndërmarrja e Transportit Publik, përkatësisht komuna e Shkupit. Kjo është bllokada e dytë brenda një jave, ndërkohë që transportuesit thonë se e njëjta mund të përshkallëzohet me dyfishimin e numrit të autobusëve, të cilët do ta bllokoni qytetin.

"Bllokadat janë paralajmërim për ndërgjegjësimin e institucioneve se nuk do të heqim dorë nga kërkesat tona. Katër muaj nuk kemi marrë paga. Gjendja e shoferëve është e rëndë pasi nga kjo punë ata mbajnë familjet e tyre. Drejtuesit e Shkupit po tallen me ndjenjat tona, por ne këtë nuk do ta lejojmë", ka deklaruar Lenin Jovanovski, kryetar i Shoqatës së Transportuesve Privatë "Slloboda Prevoz". Bllokimi i udhëkryqeve ka shkaktuar pakënaqësi në mesin e qytetarëve, të cilëve u është pamundësuar t'i kryejnë obligimet ditore. Nga Shoqata e Transportuesve thonë se



kuptojnë revoltën e qytetarëve, por kërkojnë mirëkuptimin e tyre, pasi kjo formë e protestës, sipas tyre, është mënyra e vetme për t'i realizuar kërkesat që kanë. "Qytetarët nuk mund të na kritikojnë neve. Duhet ta kritikojnë burimin e këtij problemi, që është kryetarja e Shkupit, e cila e ka lejuar këtë gjendje. Qytetarët nuk duhet të lejojnë që të kenë një kryetarë të tillë që nuk i intereson - interesi i tyre", tha Jovanovski. Përplasjet mes transportuesve privatë dhe komunës së Shkupit kanë nisur tash e një kohë për shkak të akuzave për shpërdorim të fondeve.

Inflacioni në Turqi shënon rënie për herë të parë në më shumë se një vit

Stamboll, 5 dhjetor - Inflacioni vjetor në Turqi ka shënuar rënie në nëntor, për herë të parë në më shumë se një vit, sipas shifrave zyrtare të publikuara të hënën, megjithëse ai mbetet në shkallën më të lartë në 24 vjetët e fundit.

Në muajin nëntor inflacioni ka shënuar rënie për 0.63 për qind krahasuar me një muaj më parë.

Norma mujore e inflacionit në nëntor ishte 2.88 për qind krahasuar me tetorin e cila ishte 3.51 për qind.

Sipas Instituti turk të



Statistikave, çmimet vjetore të konsumit nga 85.51 për qind në tetor u ulën në 84.39 për qind në

nëntor. Kjo është hera e parë që inflacioni vjetor në Turqi është ulur që nga maji i vitit 2021.

Lufta e Rusisë në Ukrainë dhe rënia e vlerës së lirës kanë nxitur inflacionin në këtë shtet.

Ekonomistët besojnë se në rritjen e inflacionit në Turqi kanë ndikuar edhe politikat e presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan i cili beson se ulja e normës së interesit ndikon në ulje të çmimeve, ndonëse teoritë ekonomike flasin për qasje të kundërt.

Bankat qendrore në shumë vende të botës, përfshirë ato në Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar, kanë rritur së fundi normat e interesit

me qëllim të luftimit të inflacionit.

Rritjet më të mëdha të çmimeve vjetore janë shënuar në sektorin e transportit, me 107 për qind, pasuar nga çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike me 102.55 për qind, sipas të dhënave zyrtare.

Ekspertët besojnë se inflacioni është më i lartë sesa që paraqitet në statistikat zyrtare. Grupi i Pavarur për Kërkime rreth Inflacionit ka thënë të hënën se norma e vërtetë e inflacionit në Turqi për nëntorin është 170.7 për qind.

Ukraina: Çmimi tavan ndaj naftës ruse të ulet në 30 dollarë për një fuçi

Kiev, 5 dhjetor - Ukraina përshëndeti vendosjen e çmimit tavan ndaj naftës ruse prej 60 dollarësh për një fuçi, por tha se ky çmim duhet të ulet në 30 dollarë për ta goditur edhe më shumë ekonominë ruse. "Ne e arrijmë gjithmonë qëllimin tonë dhe ekonomia e Rusisë do të shkatërrohet. Ajo do të paguajë dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha krimet e saj", ka theksuar shefi i shtabit të presidentit ukrainas, Andriy Yermak, në "Telegram". "Por, do të ishte e nevojshme që tavanin të ulet në 30 dollarë për ta shkatërruar më shpejt ekonominë e armikut", ka pohuar Yermak.

Çmimi tavan prej 60 dollarësh për një fuçi u miratua zyrtarisht nga aleatët perëndimorë më 2 dhjetor dhe u bë pas disa muajsh punë. Kjo masë ndalon

shtetet që të paguajnë më shumë se 60 dollarë për një fuçi për eksportet e naftës së papërpunuar ruse që transportohet përmes detit.

Çmimi tavan u prezantua në shtator nga shtetet e G7-s (ShBA-ja, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia, Japonia dhe Bashkimi Evropian) në përpjekje për ta goditur aftësinë e Rusisë që ta financojë luftën e saj kundër Ukrainës.

Të premtën Bashkimi Evropian miratoi çmimin tavan që kërkonte miratimin e të gjitha shteteve anëtare, pasi e bindi Poloninë që ta mbështeste këtë masë. Polonia njoftoi se do ta mbështeste masën pasi u siguroi se çmimi tavan do të mbetet 5 për qind më ulët sesa niveli në gjeje.



Është raportuar se BE-ja dëshironte të vendoste çmim tavan prej 65-70 dollarësh, por ky propozim u refuzua nga Polonia, Lituania dhe Estonia, që argumentuan se ishte një çmim i lartë.

Rusia e ka dënuar këtë masë,

teksa ka paralajmëruar se nuk do t'i furnizojë me naftë ato shtete që do ta aplikojmë çmimin tavan.

Para se Rusia ta niste pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit, mbi gjysma e eksporteve të naftës në Evropë vinte nga

Moska. Gjermania ishte importuesja kryesore, pasuar nga Holanda dhe Polonia. Por, që nga nisja e luftës shtetet e BE-së kanë tentuar ta ulin varësinë e tyre nga energjia ruse. Ndërkaq, ShBA-ja veçse e ka ndaluar naftën e papërpunuar ruse.

BE-ja bën plan për pengimin e imigrantëve ilegalë që hyjnë nga Ballkani

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Bashkimi Evropian shprehu të hënën shqetësimin e tij nga rritja e valës së imigrantëve ilegalë të cilët hyjnë në BE përmes territorit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe shpaloji një plan për adresimin e tyre.

Sipas të dhënave që ka Komisioni Evropian, vetëm në muajin tetor të këtij viti në BE kanë hyrë më shumë se 22 000 imigrantë ilegalë përmes kësaj rruge. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shifra paraqet rritje për 300 për qind. Statistikat e Frontex-it - agjencisë evropiane për ruajtjen e kufijve - tregojnë se në dhjetë muajt e parë të këtij viti mbi 281 000 imigrantë ilegalë kanë hyrë në BE përmes Ballkanit Perëndimor.

Për t'u përballur me këtë fenomen, Komisioni Evropian paraqiti një plan veprimi për Ballkanin Perëndimor. Sipas këtij plani, që prezantuan nënkryetari i KE-së, Margaritis Schinas, dhe komisionarja për punë të brendshme, Ylva Johansson, menaxhimi i kufijve me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor duhet të forcohet. Po ashtu, duhet të sigurohet qasje e shpejtë në sistemin e azilit, kapacitet për pranimin e refugjatëve, pastaj të luftohet trafikimi i migrantëve, të zbatohen marrëveshjet për ripranim dhe riatdhesim, si dhe të përshtatet regjimi i vizave të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor me atë të Bashkimit Evropian.

Në BE thonë se problem serioz paraqet fakti se në vende si Serbia, disa shtetas të vendeve të treta mund të hyjnë pa viza e pastaj ata vazhdojnë rrugën ilegale drejt Bashkimit

Evropian.

Serbia, para disa javësh, ka premtuar se do t'i rikthejë vizat për shtetasit e disa vendeve, si Burundi dhe Tunizia, ndërsa Komisioni Evropian pret nga Beogradi që këtë hap ta bëjë edhe kundrejt disa shteteve të tjera.

Komisioni Evropian u ka bërë thirrje të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor që të përshtaten me politikën e vizave të BE-së, në të kundërtën ka paralajmëruar se rrezikohet edhe liberalizimi i vizave që BE-ja ka me shumicën e vendeve të këtij rajoni. "Nuk është e pranueshme që vendet e rajonit, që gëzojnë liberalizim vizash me BE-në, të lejojnë që territori i tyre të përdoret për ardhjen ilegale të imigrantëve drejt BE-së. Duhet t'i forcojmë kapacitetet e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor për ta kontrolluar kufirin, duke i ndihmuar ato edhe përmes pranisë së BE-së në terren dhe përmes goditjes së rrjeteve të trafikimit të njerëzve", tha Schinas.

Ai në mënyrë specifike përmendi kontrollin e kufirit mes Serbisë dhe Hungarisë, vend anëtar i BE-së.

Aktualisht BE-ja ka të shpërndarë rreth 500 zyrtarë të agjencisë Frontex në kufijtë mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, por Komisioni Evropian kërkoj që Frontex-i të ndihmojë edhe në kontrollin e kufijve mes vendeve të rajonit. Johansson kërkoj që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian, t'i regjistrojnë imigrantët që hyjnë në territoret e tyre. Ajo tha se



numri i kërkuesve të azilit është shumë më i lartë se numri i hyrjeve të regjistruara në kufijtë e jashtëm të BE-së.

Johansson, po ashtu, përmendi nevojën që Serbia, sa më shpejt, ta përshtatë regjimin e vizave me atë të Bashkimit Evropian. "Serbia po ndryshon politikën e saj me Tunizinë dhe Burundin. Ka premtuar se këtë do ta bëjë edhe me Indinë... Shumica e atyre [imigrantëve ilegalë] që kanë arritur në BE kanë ardhur përmes Serbisë", tha Johansson, duke rikujtuar se obligimi për ta përshtatur regjimin e vizave vlen edhe për vendet e tjera të rajonit. E pyetur nga gazetarët nëse ka raste të keqpërdorimit të hyrjes

pa viza edhe nga vende të tjera, jashtë Serbisë, Johansson tha se "sa iu përket ardhjeve masive, ato kanë ndodhur vetëm në rastin e Serbisë". Por, ajo shtoi se BE-ja duhet të jetë vigjilente edhe ndaj vendeve të tjera në të ardhmen, kur Serbia të rivendosë viza për shtete të caktuara dhe ardhjet të bëhen përmes vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Nga gjashtë vendet e këtij rajoni, që nuk janë anëtare të BE-së, liberalizim vizash me bllokun evropian kanë: Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina. Kosova është e vetmja që nuk ka, por javën e kaluar zyrtarë të

BE-së kanë miratuar një vendim që liberalizimi i vizave për qytetarët kosovarë të bëhet jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024.

Rruga ballkanike ka vite që përdoret nga imigrantët ilegalë. Në vitin 2015 BE-ja është përballur me fluksin më të madh të të ardhurve në disa dekada.

Mbi 1 milion njerëz të ikur kryesisht nga luftërat dhe varfëria në Lindjen e Mesme dhe pjesë të Afrikës kanë hyrë në vendet e bllokut evropian, duke përdorur rrugë të ndryshme nga deti dhe toka, përfshirë edhe atë ballkanike. (rel)

Veteranët paralajmërojnë protesta nëse nuk përfshihen në pagën minimale

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ushtruesi i detyrës i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Faton Klinaku, ka thënë se nëse në Kuvendin e Kosovës del në lexim Projektligji për Pagën Minimale, atëherë do të protestojnë. "Përsëri filluan sot që t'i bëjnë temë veteranët e që, për mendimin tim, kjo bëhet vetëm për vota, prandaj nuk duhet t'u besohet. Sa i përket asaj se si qeveri paskan bërë disa hapa që të vijnë në një gjuhë të përbashkët me shoqatat e dala nga lufta dhe subjektet opozitare, absolutisht nuk është e vërtetë, sepse që nga shkresa e dërguar të kryeministri Kurti, nuk ka pasur më asnjë kontakt në mes nesh e rreth kësaj teme", ka thënë Klinaku.

Ai u ka bërë thirrje veteranëve,

invalidëve e familjeve të dëshmorëve të jenë të gatshëm për protesta. "Sa i përket çfarëdo ligji të ri për veteranët, apo amendamentim të ligjeve aktuale në fuqi, këtë gjë e kemi thënë se kur dhe si mund të bëhet kjo, në shkresën tonë drejtuar qeverisë, prandaj po e publikoj edhe një herë shkresën që të mos manipulohet publiku. Nëse e kanë qëllim që të përgatitet apo manipulohet publiku e pastaj të dalë në Kuvend për lexim të dytë projektligji që i heq veteranët nga paga minimale, e them përsëri se ne do të jemi në protesta në oborr të Kuvendit. Veteranë të nderuar, invalidë e familje të dëshmorëve, të jeni të përgatitur që, nëse ju thërrasim në protestë, të dilni sa më masivisht", ka thënë Klinaku.





NDIHMËSADMINISTRATORJA PËR EVROPË DHE EUROAZI NË USAID, AMBASADORJA ERIN E. MCKEE DHE PRESIDENTJA VJOSA OSMANI KANË MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

McKee: Normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi me njohjen në qendër, mënyra më e mirë

Ndihmësadministratorja për Evropë dhe Euroazi në USAID, ambasadorja Erin E. McKee, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, ka thënë se normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, me njohjen reciproke në qendër, është mënyra më e mirë për përmirësim të raporteve mes fqinjëve. Ajo ka theksuar se USAID-i do të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën për zhvillimin e një gjyqësori të drejtë dhe të paanshëm, si dhe për zvogëlimin e nivelit të korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ndihmësadministratorja për Evropë dhe Euroazi në USAID, ambasadorja Erin E. McKee, pas takimit që ka pasur të hënën me presidenten Vjosa Osmani, ka thënë se normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër, është mënyra më e mirë për përmirësim të raporteve mes fqinjëve. "Normalizimi i raporteve në mes të Kosovës

dhe Serbisë, me njohjen e ndërsjellë në qendër, është mënyra më e mirë që t'i ndihmojë Kosovës t'i përmirësojë raportet e saj me vendet fqinje dhe në këtë mënyrë edhe të zë vendin e vet në mesin e vendeve të tjera në kuadër të integritimit evropiane", ka thënë McKee. Ambasadorja e USAID-it ka thënë se do të jenë këtu për t'i ndihmuar të gjitha vendet e rajonit. "Jam shumë e kënaqur që jam këtu në Kosovë në mënyrë që të jem dëshmitare e shumë sukseseve që kemi

arritur gjatë dy dekadave të fundit. Ne do të jemi këtu për të gjitha vendet e rajonit, që të krijojmë një mjedis ku të rinjtë nuk do ta shohin më të ardhmen jashtë atdheut të tyre", ka thënë McKee, duke theksuar se do ta ndihmojnë Kosovën në demokratizimin e vendit. "USAID-i do të vazhdojë ta ndihmojë zhvillimin e një gjyqësori të drejtë dhe të paanshëm. Dhe, gjithashtu, do të ndihmojmë në zvogëlimin e nivelit të korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit", është shprehur ajo.

McKee ka bërë me dije se USAID-i do të ndihmojë edhe në zhvillimin e sektorit privat, ku të rinjtë me ide të reja do ta arrijnë potencialin që Kosova meriton ta realizojë. Ajo ka pohuar se ardhmëria e Kosovës varet edhe në forcimin e sistemit energjetik. Ndërkaq presidentja Vjosa Osmani ka shprehur mirënjohje për USAID-in në kontributin që ka dhënë për forcimin e institucioneve të Kosovës. "Ne ju jemi mirënjohës që edhe vendi ynë ka qenë përfitues i shumë projekteve që janë mbështetur nga populli amerikan. Në emër të popullit të Kosovës, natyrisht që falënderimi është i madh për këtë kontribut të popullit amerikan. USAID-i ka kontribuar me më shumë se 1 miliard dollarë në forcimin e institucioneve të Kosovës, në demokratizimin e vendit tonë, në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme e

gjithëpërfshirëse e në shumë fusha të tjera që përfshin edhe luftimin e krimit dhe korrupsionit", ka theksuar Osmani, duke shtuar se mbështetja e USAID-it ka qenë edhe në shëndetësi, energji dhe në luftën e pandemisë Covid-19. Ajo ka treguar se me McKeen kanë diskutuar edhe për fushat e tjera të bashkëpunimit. "Konkretisht kërkoja mbështetje për përpjekjet tona për eliminimin e dhunës mbi baza gjinore dhe natyrisht që jam shumë e lumtur që mora përgjigje pozitive nga ana e USAID-it për përkrahje në këtë drejtim për ta luftuar këtë dukuri e cila, për fat të keq, është shndërruar në pandemi anekënd globit", ka thënë presidentja Osmani. Presidentja ka theksuar se Republika e Kosovës do të mbetet partnere e ngushtë e USAID-it.

Lansohet Protokoli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale

Prishtinë, 5 dhjetor - "Protokoli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale është një dokument pune për t'u përdorur nga të gjitha institucionet përgjegjëse për trajtimet e rasteve të dhunës seksuale", ka thënë kryeministri i Albin Kurti në ceremoninë e lansimit të tij. Kurti ka theksuar se ky Protokoll Shtetëror synon t'i qartësojë të gjitha institucionet përgjegjëse se nuk ka rëndësi nëse viktimave apo e mbijetuara kontakton së pari në urgjencë, denoncon rastin në polici, kontakton me mbrojtësin e viktimave apo kërkon ndihmë në një qendër të specializuar të shërbimeve për gratë e dhunuara.

Ai ka theksuar se e rëndësishme është që, pavarësisht se cili institucion merr informacionin e parë për rastin, duhet të fillojë menjëherë trajtimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm dhe duhet të përmbushen të gjitha nevojat specifike të viktimave nëpërmjet

qasjes shumësektoriale e të koordinuar. "Shpeshherë në rastet e paraqitura institucionet nuk i kanë kryer e nuk i kanë zbatuar obligimet e tyre ligjore, duke i lënë viktimat pa trajtimin që u takon dhe që ato e meritojnë. E, po ashtu, në raste të këtilla dhunuesit dhe abuzuesit nuk e kanë marrë dënimin e merituar", ka deklaruar kryeministri.

Duke përmendur veprimet e ndërmarra nga qeveria, ai veçoi ndryshimet ligjore në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Kryeministri Kurti ka theksuar ndryshimet në rastet kur një person shpallet fajtor për veprën penale të dhunës në familje apo të dhunës seksuale: do t'i ndalohet punësimi në institucionet publike; do t'i ndalohet kandidimi në pozita qoftë në nivel lokal apo qendror; do t'i merret leja e vozitjes; nuk do të zbatohen rrethanat lehtësuese për dhunuesit; trajtimi



i këtyre lëndëve nuk do të zgjasë më shumë se një vit dhe emrat e dhunuesve do të publikohen në faqen zyrtare të KGJK-së. "Pas këtyre ndryshimeve ligjore, për

ashpërsimin e dënimeve ndaj dhunuesve, zbatimi i këtij protokollit do t'u dalë në ndihmë dhe mbrojtje viktimave", theksoi kryeministri Kurti.

Kryeministri uroi që zbatimi i protokollit të fillojë dhe të japë rezultate të menjëhershme të trajtimit të viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë ka nevojë për reforma të mirëfillta

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Koalicioni i OJQ-ve, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Lëvizja Fol, Iniciativa për Progres, Çohu dhe Columbus, të hënën kanë organizuar tryezë, në të cilën kanë diskutuar për reformën në drejtësi. Në këtë diskutim kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, shoqërisë civile, Agjencisë Kundër Korrupsionit si dhe pjesëtarë të partive politike.

Eros Gashi, këshilltar i Ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se Ministria e Drejtësisë dhe qeveria janë marrë jashtëzakonisht me iniciativat ligjore për reforma në drejtësi dhe për realizimin e prioritetit qeveritar për realizimin e këtij qëllimi.

Gashi ka përmendur iniciativat ligjore të ndërmarra nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, përfshirë Byronë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Vetingun, si dhe një sërë të iniciativave ligjore që ka thënë se përfshijnë reformimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor.

Liridon Salihu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka thënë se GLPS-ja në vazhdimësi ka potencuar faktin se sistemi i drejtësisë në



Republikën e Kosovës ka nevojë për reforma të mirëfillta. Ai tha se, pavarësisht prej reformave që kanë qenë edhe në të kaluarën, konsiderojnë që edhe në vitin 2022 sistemi gjyqësor vazhdon të jetë jotransparent, joefikas dhe i cenueshëm nga ndikimet qoftë brenda apo jashtë pushtetit gjyqësor. Ai ka shtuar se të njëjtët konsiderojnë që është pozitive që tashmë është gati pakoja e vetingut e që, sipas tij, kjo pako në përgjithësi ka adresuar edhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Venecias. Sipas Gzim Shalës nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD),

reformat në sistemin e drejtësisë nuk janë zhvilluar në mënyrë adekuate. Sipas tij, vetingu ende nuk ka filluar derisa as në Kuvend, Byrosë për Konfiskimin dhe Verifikimin e Pasurisë nuk i është dhënë pavarësi objektive. Sa i përket Gjykatës Komerciale, Shala ka thënë se kjo gjykatë është themeluar, por mosmbështetja e saj me buxhet adekuat për numrin e gjyqtarëve ia humb kuptimin themelimit të saj. Në kundërshtim me Kushtetutën, Shala thotë se janë ulur pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe në kundërshtim me Kushtetutën

është inkorporuar në MD. Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Yll Buleshkaj, ka bërë me dije se këtë vit ka pasur hapa të rëndësishëm për krijimin e të ashtuquajturës kornizë ligjore për aspektet e parandalimit të korrupsionit duke filluar me aprovimin e Ligjit për Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit ku, sipas tij, u është fokusuar tashmë veprimtaria në aspektet e parandalimit dhe u janë dhënë dhe disa mekanizma tepër të rëndësishëm, të cilët, në qoftë se arrijnë t'i zbatojnë, beson se do të kontribuojnë fuqishëm në

parandalimin e korrupsionit. Ai ka thënë se Agjencia nuk ka burime qoftë njerëzore qoftë financiare për zbatim në plotni të këtij mandati të ri, derisa versioni i parë apo projektligji i parë nuk i ka përfshirë të gjitha kërkesat tona për buxhet shtesë, por se beson fuqishëm që këto kërkesa tona do të adresohen nga Kuvendi i Kosovës.

Përparim Gruda, koordinator i projektit për drejtësi në kuadër të kabinetit të qeverisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), duke komentuar se çfarë ka bërë qeveria gjatë dy vjetëve në pushtet, ka thënë se ka pasur mungesë totale të koordinimit të qeverisë me pushtetin gjyqësor. Sipas tij, pushteti gjyqësor është sulmuar, duke shtuar se asnjëherë nuk kanë parë ministra që i komentojnë aktakuzat dhe aktgjykimet.

Ndërkaq lidhur me procesin e vetingut, Gruda ka thënë se qeveria nuk ka treguar seriozitet. Ky organizim bëhet në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit, e cila organizohet nga Koalicioni i OJQ-ve.

Në këtë organizim janë të ftuar të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë në Kosovë me qëllim të sensibilizimit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies sa i përket luftës kundër korrupsionit.

Motoja e "Javës Kundër Korrupsionit për vitin 2022", e Koalicionit të OJQ-ve është "Bashkë Kundër Korrupsionit".

Tri shkolla të reja do t'i shtohen kryeqytetit

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka nënshkruar

kontratën për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tri shkollave të reja në Prishtinë. Sofali, Mat 1 dhe

Prishtina e re në Veternik. Privat (PPP) për bashkëpunimin e Departamentit të Partneritetit Publiko-

Privat (PPP) për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



Komuna e Drenasit nënshkruan memorandum për hapjen e puseve për ujë të pijshëm

DRENAS, 5 DHJETOR - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, në bashkëpunim me organizatën “Qatar Charity”, kanë filluar implementimin e projektit për hapjen e puseve për furnizim me ujë për fermerë.

Fillimin e punimeve për këtë projekt e kanë përcjellë nga afër përfaqësues të organizatës “Qatar Charity” bashkë me drejtoreshën e Bujqësisë, Anita Avdullahu.

Me këtë rast, nënkryetari Shala dhe drejtoresha Avdullahu kanë falënderuar organizatën “Qatar Charity” për bashkëpunimin në

realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për banorët të cilët kanë pasur nevojë jetike sigurimin e furnizimit të rregullt me ujë.

Nënkryetari Shala ka theksuar se komuna e Drenasit ka realizuar disa projekte të rëndësishme për banorët gjatë këtyre viteve si në sigurimin e kushteve më të përshtatshme për banorët, po ashtu edhe në dhënien subvencioneve dhe ka shtuar se do të vazhdojnë të realizojnë projekte të tjera në mënyrë që ta stimulojnë zhvillimin e ekonomive familjare.



Kuvendi Komunal i Podujevës, vizitë studimore edhe në komunën e Ulqinit



PODUJEVË, 5 DHJETOR - Në kuadër të vizitës studimore, delegacioni i Kuvendit Komunal të Podujevës, i priur nga kryesuesi Hilmi Hoxha, ka vizituar komunën e Ulqinit, ku është pritur nga kryetari i Kuvendit të kësaj komune, Ardijan Mavriq, sekretarja e Kuvendit, Valdete Osmani dhe anëtarët e sekretarisë.

Kryetari Mavriq, duke u uruar mirëseardhje mysafirëve nga komuna e Podujevës, u shpreh i lumtur që për herë të parë një delegacion nga komuna e

Podujevës viziton komunën e Ulqinit.

Mavriq me këtë rast ka folur për qeverisjen lokale, ku ka prezantuar edhe parimet kryesore të funksionimit të Kuvendit Komunal, strukturën e Kuvendit, miratimin e vendimeve, kompetencat si dhe sfidat e Kuvendit.

Ndërsa kryesuesi i Kuvendit Komunal të Podujevës, Hilmi Hoxha, ka falënderuar kryetarin Mavriq për mikpritjen vëllazërore dhe ka theksuar se

komuna e Podujevës është e gatshme për krijimin e bashkëpunimit mes dy komunave me qëllim të shkëmbimit të përvojave të mira dhe bashkëpunimit në projektet e ardhshme në fusha të ndryshme të kulturës, sportit dhe turizmit.

Anëtarët e delegacionit nga Kuvendi Komunal i Podujevës u interesuan për funksionimin e Kuvendit Komunal të Ulqinit dhe e falënderuan kryetarin Mavriq për mikpritjen.

“Rc Cola Kosova” po kontribuon drejtpërdrejt në lehtësimin e barrës elektro-energjetike



GJILAN, 5 DHJETOR - Bashkë me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ishin për vizitë në kompaninë gjilanasë “Rc Cola”, e cila së fundmi ka investuar 400 000 euro në energji të ripërtërishme dhe eficientë të

energjisë, duke realizuar projektin e instalimit të paneleve solare. “Përmes sistemit fotovoltaik, pra energjisë së diellit (paneleve solare), zvogëlohet barra e sistemit elektro-energjetik, ndërkaq ky investim kthehet brenda periudhës

shtatëvjeçare. Projekti u zhvillua nga kompania vendore ‘Jaha Solar’, në bashkëpunim me USAID Kosovo”, ka thënë Hyseni, duke falënderuar “Rc Cola Kosova” për kontributin në lehtësimin e krizës energjetike në vend dhe ruajtjen e mjedisit.

Përkujtohen të rënët e Pashtrikut

RAHOVEC, 5 DHJETOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka përkujtuar të rënët në bjeshkët e Pashtrikut. Latifi ka thënë se rrugëtimi atdhetar e luftarak i dëshmorëve, të rënët në dhjetor të vitit '98 në bjeshkën e Pashtrikut, përbën një nga ngjarjet më tragjike e heroike

njëkohësisht. “Muhamet Malsori, Hysni Duraku dhe studentët-dëshmorë, Hida, Ismet, Isak, Sedat e Sinan Hoti nga Krusha e Madhe, së bashku me Skender Hamelin nga Mazreku i Hasit, i ujitën me gjak themelet e lirisë”, ka thënë kryetari i Rahovecit. Latifi ka thënë se ata i kuptuan malet e ashpra të

Pashtrikut, me zjarrin e lirisë në zemra, duke sfiduar rreziqet, acarin e vështirësitë e mëdha. “Kujtimi dhe nderimi për ta është detyrim njerëzor e institucional. Vetëm në këtë mënyrë do të jemi në gjendje ta ndërtojmë të ardhmen e brezave. Lavdi e nderim për dëshmorët e dhjetorit!”, ka thënë Latifi.



BQK-ja: Sektori bankar është i sigurt, nuk ka nevojë për panik

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Pas publikimit të disa artikujve nëpër medie për pasigurinë e të dhënave të qytetarëve nëpër bankat komerciale në Kosovë, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka siguruar qytetarët se sektori bankar është i sigurt dhe nuk ka nevojë për panik. “Përkundër sfidave të ndryshme teknologjike, BQK në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe bankat komerciale kanë ndërmarrë të gjitha masat, që klientët të mos dëmtohen nga asnjë veprim i kundërligjshëm. Bazuar në kompetencat e saj, BQK kryen ekzaminime të plota dhe të fokusuar që përfshijnë edhe fushën e teknologjisë informative, duke përfshirë edhe sigurinë kibernetike”, është thënë në reagimin e BQK-së.

Sipas BQK-së, pjesë e ekzaminimeve kanë qenë edhe gjetjet që kanë të bëjnë me fushën e teknologjisë informative, ku janë dhënë rekomandime të ndryshme, të cilat zbusin dhe zvogëlojnë mundësinë e kryerjes së keqpërdorimeve, duke rekomanduar vendosjen e kontrolleve adekuate të brendshme në funksion të parandalimit edhe ndaj sulmeve kibernetike. “Gama e gjerë e produkteve që ofrojnë



bankat, bart me vete edhe rrezikun e ekspozimit ndaj sulmeve kibernetike, mirëpo në çdo rast kur ka dëmtim të klientëve të çfarëdo natyre bankat bartin koston e zhdëmtimit të klientëve. Për më shumë, ka pasur raste kur BQK-ja ka kërkuar dhe bankat kanë zhdëmtuar klientët ndaj çfarëdo rreziku. Gjithashtu, BQK është duke bashkëpunuar

ngushtë me të gjitha institucionet e sigurisë për të adresuar çdo nevojë për zgjidhjen e problemeve në këtë sektor”, theksohet në reagimin për medie.

BQK-ja, gjithashtu, ka njoftuar se është angazhuar shumë për zgjidhjen e të gjitha ankesave të konsumatorëve dhe e ka ndër prioritetet kryesore të saj mbrojtjen e të drejtave të

konsumatorëve. “Falë fushatave të ndërmarrë është rritur edhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të raportuar për rastet. Nga viti 2018 deri më tani numri i ankesave të qytetarëve për keqpërdorim të kartelave bankare është 139 (2018-12; 2019-36; 2020-29; 2121-18; 2022-44). Vitet e fundit transaksionet elektronike, që ndryshe njihen si blerjet nga

interneti, kanë shënuar rritje të madhe dhe interesimi i klientëve të bankave për të operuar në këtë fushë është i madh. Deri në tetor të këtij viti janë lëshuar mbi 1 milion kartela për blerje elektronike dhe janë bërë 38 mijë e 112 transaksione në vlerë prej 2 milionë e 431 mijë e 910 eurosh”, është theksuar në reagimin e BQK-së.

Draftligji për pagat në sektorin publik, degradues për kryetarin e komunës, e barasvlerëson me një zv/ministër



EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Bordi i Asociacionit i Komunave të Kosovës ka vlerësuar se Draftligji për pagat në sektorin publik edhe njëherë atakon lidhshimin në nivelin lokal, me theks kryetarët e komunave, sepse në një formë del kundër përgjegjësitë që ka një kryetar komune në raport me një pozitë qeveritare me pagë të ngjashme, (p.sh. një zëvendësiministër). “Në asnjë mënyrë postulati i reklamuar nga qeveria që për punë të njëjtë të jetë paga e njëjtë nuk vlen në këtë rast dhe jo vetëm. Përshtatim bën kryetari i kryeqytetit. Paga e kryetarëve të komunave të Kosovës është nënçmuese edhe

për mënyrën e zgjedhjes, edhe për përgjegjësitë që ka kryetari i komunës”, ka njoftuar AKK-ja. Sipas këtij njoftimi, kryetari i komunës, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përgjegjësitë i ka tejet të mëdha, përveç që zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, kryetari i komunës përfaqëson komunën dhe ka përgjegjësi direkte ndaj qytetarëve të saj: udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës; ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve të tij. “Ndërsa, në anën tjetër, një zëvendësiministër ndihmon ministrin dhe është pjesë e hierarkisë administrative,

zëvendëson ministrin në rastet e mungesës së tij të përkohshme apo për përgjegjësitë e deleguara shprehimisht nga ministri. Po ashtu, me këtë projektligj shihet qartë që emërimi politik i një zëvendësiministri bëhet më i rëndësishëm dhe më i çmuar se një kryetar komune i zgjedhur me zgjedhje të drejtpërdrejta nga qytetarët. Pra, si të tilla, këto përgjegjësi nuk reflektojnë nivelin e pozicionimit të një kryetari komune në draftligjin e pagave”, ka njoftuar AKK-ja. Asociacioni i Komunave të Kosovës ka theksuar se do të angazhohet me gjithë kapacitetin e vet që këto ndryshime të reflektohen në projektligjin për paga në sektorin publik në takimet me komisionet parlamentare.

Çmimi i energjisë elektrike në berzën ndërkombëtare arriti mbi 400 euro për megavat/orë

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ditët e fundit në berizat rajonale çmimi i energjisë elektrike i kohës së pikut ka arritur mbi 400 euro për megavat/orë. Kjo paraqet rritje gati 100 për qind në krahasim me

çmimin prej 250 eurosh sa ishte një javë më herët. Ky trend vazhdimisht i rritjes kaq të madhe të çmimit të energjisë elektrike që po vjen bashkë me ftohjen e motit, sipas parashikimeve

të ekspertëve të tregut të elektroenergjetikës, me gjasë do të jetë më i lartë gjatë ditëve e javëve në vijim.

KEDS/KESCO ka njoftuar se konsumi i energjisë elektrike

në Kosovë së fundi ka arritur në mbi 1100 megavat/orë, për çka nevojitet që një sasi e konsiderueshme e energjisë elektrike të importohet me qëllim të përmbushjes së kërkesës.



Rënia e ndjeshme e rritjes ekonomike në Kosovë, sfidë për konsumatorët dhe bizneset



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Raportet e institucioneve ndërkombëtare thonë se trysnia e krijuar nga inflacioni global pas agresionit rus në Ukrainë ka ndërprerë rrugën e rimëkëmbjes së hovshme ekonomike të Kosovës. Institucionet si Banka Botërore kanë ulur parashikimet për rritje ekonomike të Kosovës këtë vit në 3.2 për qind, një shifër shumë më e ulët se vitin e kaluar kur Kosova shënoi rritje ekonomike mbi 10 për qind. Në një punëtori të vogël në qendër të Prishtinës, Veton Jusufi prej mbi 35 vjetësh ushtron zejen e prodhimeve nga lëkura. Në rafte shihen çanta e kuleta, punë dore e Jusufit. “Punoj vetëm me një lloj të lëkurës. Është lëkurë lope e cila përpunohet vetëm në ujë të perimeve edhe në kripë. Procesi i përpunimit të një cope të lëkurës zgjat diku 40 ditë, meqë rri në ujë, pastaj i hiqen qimet më të mëdha dhe teret në diell. Ajo mandej na mundëson kohëzgjatje, gravim, ngjyrosje edhe shumëçka tjetër”, ka bërë me dije ai. Jusufi thotë se interesimi për prodhimet e tij është i lartë, por fuqia blerëse është e kufizuar. “Nuk ka njeri që kalon këtu pranë dyqanit e nuk ndalet të shohë e të pyesë për punën tonë. Por për standardin që e kemi ne sot, këto janë mallra të

shtrenjta, edhe pse ne punojmë me një të pestën e çmimit sa e kanë vlerën këto punime në Perëndim, por prapë është shtrenjtë për komunitetin tonë”, ka thënë ai. Që nga agresioni rus në Ukrainë mirëmbajtja e kësaj veprimtarie është bërë edhe më sfiduese për të për shkak të çmimit të lëndës së parë. “Çmimi i lëkurës është rritur mbi 30 për qind si çmim, si vlerë e cila për bazë e ka dollarin. Tash në muajt e fundit devaluimi i euros në krahasim me dollarin na e ka shtrenjtuar edhe për 15 për qind lëkurën, njëjtë ngjyrat, ngjitesit e të gjitha të tjerat që lëvizin në bazë të berzës e dollarit. Pra çmimet mund të them se kanë shkuar deri në 40 apo 45 për qind më lart se që kanë qenë”, thotë Jusufi. Në përpjekje për t'i ruajtur klientët, ai thotë se nuk i ka ngritur çmimet e prodhimeve aq sa janë ngritur çmimet e lëndëve të para. “Në princip ka qenë kjo, por edhe ngritja e një çmimi prej 40 apo 50 për qind është shumë e madhe dhe në një mënyrë psikologjikisht ndikon shumë te njerëzit. Atëherë ne kemi menduar të bëjmë një zbritje të fitimit, një ngritje të çmimit dhe ta sjellim në një vend ku as klienti nuk do ta vërejë shumë, por edhe ne të mos punojmë me humbje”, thotë ai.

Sipas raporteve nga institucionet ndërkombëtare, trysnia e krijuar nga inflacioni global pas agresionit rus në Ukrainë ka ndërprerë rrugën e rimëkëmbjes së hovshme ekonomike të Kosovës pas pandemisë së Covid-19. Institucione si Banka Botërore kanë ulur parashikimet për rritje ekonomike të Kosovës këtë vit në 3.2 për qind, një shifër shumë më e ulët se vitin e kaluar kur Kosova shënoi rritje ekonomike mbi 10 për qind. Ekspertë të fushës së ekonomisë thonë se këto parashikime kanë qenë të pritshme për shkak të krizës ekonomike që ka nxitur gjithandej lufta në Ukrainë. Në një bisedë me “Zërin e Amerikës”, Lekë Musa, njohës i fushës së ekonomisë, ka thënë se konsumi ka qenë faktor thelbësor i zhvillimit ekonomik të Kosovës në 20 vjetët e fundit, ndërsa ka theksuar se rënia e tij godet posaçërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. “Tani në kohë krizash konsumi ka tendencë të ngadalësohet dhe të bie dhe të ketë një ndikim në shumë sektorë, kryesisht atë primar të furnizimit, e dimë që në Kosovë shporta e konsumit kryesisht ka të bëjë me produktet bazike ushqimore dhe mund të pritët që kjo të ketë një efekt në ndërmarrje të vogla dhe të mesme për shkak

të rënies së konsumit dhe kjo automatikisht do të ketë edhe efektin në vende të punës”, thotë ai. Ish-kryetari i Odës Ekonomike, Berat Rukiqi, ka thënë se rënia e rritjes ekonomike të Kosovës ngre shqetësime mbi mirëqenien ekonomike në vend. “Ka pasoja në të ardhurat e qytetarëve, ka pasoja në shumë projekte të cilat kanë qenë të pritshme në përmirësimin e infrastrukturës publike, përmirësimin e sektorit të energjisë e kështu me radhë. Në fund të ditës pasojat e një rënieje të tillë të rritjes ekonomike e ndiejnë qytetarët, e ndiejnë kompanitë dhe normalisht pjesa tjetër që janë të ndërlidhur dhe sigurisht buxheti i vendit”, ka thënë Rukiqi. Ndërkaq një banor i Prishtinës, Bashkim Shkurti, ka theksuar se çmimet janë ngritur, mundësia e blerjes ka rënë, njerëzit janë në krizë mjaft të madhe. “Meqë rritja ekonomike te ne është e ulët, mendoj se kjo krizë ekonomike në kohën e fundit është një ndër krizat më të mëdha që kemi përjetuar ne si qytetarë të rëndomtë”, ka thënë ky banor. “Gjatë këtij viti çmimet janë rritur në shkallë të papërbalueshme për familjet, pagat për ata që janë në punë kanë mbetur të njëjta si në sektorin publik ashtu edhe në

atë privat. Gjithashtu, nuk kanë lëvizur pensionet që sa vite. Në të gjitha shtetet serioze pensionet duhet të lëvizin në bazë të shkallës së inflacionit”, thotë një tjetër banor i Prishtinës, Sejdi Osmani. Në raportin e Bankës Botërore thuhet se në kontekstin aktual, për ta zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve, duhet të mbështeten kategoritë më të cenueshme të shoqërisë. Sipas një hulumtimi të Institutit për Studime të Avancuar GAP, Qeveria e Kosovës nga muaji janar e deri në muajin qershor të këtij viti ka ndarë mbi 125 milionë euro për rimëkëmbjen ekonomike. Njohësi i fushës së ekonomisë, Lekë Musa, tërheq vërejtjen te mënyra e organizimit të ndihmës financiare për kategoritë e cenueshme. “Mendoj se politikat duhet të planifikohen në një formë që, përpos ndikimit direkt te shtresat që dëshirohen të ndihmohen, të arrijmë të kemi edhe një ndikim në ekonomi. Kjo mund të bëhet duke bërë përzgjedhjen e duhur të këtyre shtresave që ndihmohen dhe të shihet në anën tjetër që kjo ndihmë të jetë e ndërtuar në atë formë që efektet të ndërlidhen me sektorë të caktuar, ku në mënyrë indirekte ndihmohen ta zëmë këta sektorë primarë të prodhimit të ushqimeve apo të një zinxhiri të furnizimit i cili mund të krijojë edhe vende pune”, thotë ai. “Urgjentisht të trajtohet kjo pjesa e investimeve publike, urgjentisht të merren masa për të lehtësuar investime në energji që janë disa prej investimeve që mund të nxisin kapital privat apo edhe projekte publiko-private, e njëjta vlen për shëndetësinë, e njëjta vlen edhe për pjesën e përkrahjes së vazhdueshme për eksport, për ta shfrytëzuar këtë moment që kemi rritje të eksportit dhe ta dyfishojmë atë”, ka thënë ish-kryetari i Odës Ekonomike, Berat Rukiqi. Sipas parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rritja ekonomike e Kosovës për vitin 2023 pritët të jetë tre deri katër për qind.

Hoti: Serbia bëhet partnere kryesore tregtare e Kosovës në rajon

Prishtinë, 5 dhjetor - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka theksuar se importet rriten me 850 milionë euro dhe Serbia kthehet si partnere kryesore tregtare e Kosovës në rajon. “Gjatë periudhës janar-tetor 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, janë importuar 850 milionë euro më shumë mallra nga jashtë. Për shkak se eksportet për këtë periudhë janë rritur vetëm

me 154 milionë euro, deficitit tregtar është thelluar dhe ka arritur në -3.9 miliardë euro”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Ai ka thënë se thellimi i deficitit tregtar e vë në dyshim rritjen ekonomike, të prodhimit vendor dhe të punësimit në Kosovë, siç po propagandohet nëpër konferenca ndërkombëtare. “Nëse e analizojmë tregtinë me vendet e Ballkanit

Perëndimor, shohim se importet me të gjitha këto vende janë ulur pa përjashtim, përveç me Serbinë. Dikush mund të thotë se tregtia është e lirë dhe ajo i përcakton importet dhe eksportet. Dakord jam me këtë, por tregtia e lirë ka ekzistuar edhe në vitet kur këta që sot qeverisin i rrotullonin kamionët me mallra nga Serbia”, është shprehur Hoti.



Pse jemi kaq të fiksuar pas besëtytnive?



Nga Dimitris XYGALATAS

Duke qenë se jam rritur në Greqi, sezonin e verës e kaloja gjithmonë në shtëpinë e gjyshërve të mi në një fshat të vogël bregdetar në rajonin e Halkidhikisë. Moti ishte i nxehtë, plot diell dhe shumicën e kohës e kaloja duke luajtur në rrugë me kushërinjtë e mi. Por herë pas here, stuhitë e verës sillnin reshje të mëdha shiu.

Ato mund të shiheshin teksa vinin që nga larg, me retë e zeza që shfaqeshin mbi horizont, të ndriçuara nga rrufetë. Ndërsa kthehesha në shtëpi me vrap, më bënte gjithmonë përshtypje mënyra sesi gjyshërit e mi merrnin masat për stuhinë.

Gjyshja mbulonte me shpejtësi me një copë të errët pasqyrën e madhe në murin e dhomës së ndenjes dhe hidhte një batanije mbi televizor. Ndërkohë, gjyshi ngjiste shkallët për të hequr llambën që ndodhej mbi derën e oborrit. Pastaj fiknin të gjitha dritat në shtëpi. Nuk e kuptova kurrë pse e bënin gjithë ato veprime.

Kur i pyesja, më thoshin se energjia elektrike e tërheq rrufenë. Të paktën kështu thoshin njerëzit, ndaj më mirë të jesh i sigurt. Po nga vijnë këto lloj besimesh? Magjepsja ime

me besimet dhe praktikat kulturore në dukje të çuditshme, më nxiti të bëhesha antropolog.

Unë kam vëzhguar besëtytni të ngjashme anembanë botës, dhe megjithëse dikush mund të mrekullohet nga shumëllojshmëria e tyre, ato ndajnë disa tipare të përbashkëta. Në thelbin e shumicës së besëtytnive, qëndrojnë disa koncepte intuitive mbi mënyrën se si funksionon bota.

Antropologët e hershëm i përshkruan me terma si "ngjashmëria" dhe "infektiviteti". Sipas parimit të ngjashmërisë, gjërat që duken njësoj mund të ndajnë një lidhje më të thellë, ashtu si anëtarët e një familjeje priren t'i ngjajnë njëri-tjetrit si në pamje ashtu edhe në tipare të tjera. Natyrisht, nuk është gjithmonë kështu. Por ky përfundim duket i natyreshëm, ndaj ne shpesh abuzojmë me të. Në rastin në fjalë: Drita e reflektuar në sipërfaqen e një pasqyre, nuk lidhet me dritën që buron nga shkarkesat elektrike të prodhuara gjatë një stuhie.

Por për shkak se që të dyja duket se lëshojnë dritë, një lidhje midis të dyve ishte dikur shumë e besueshme në shumë pjesë të botës. Po kështu, për shkak se reflektimi ynë në pasqyrë ngjan shumë me imazhin tonë, shumë

kultura mendojnë se thyerja e një pasqyre sjell fat të keq, sepse besojmë se dëmtimi i atij reflektimi do të nënkuptonte edhe dëmtimin e vetes tonë.

Parimi i infektivitetit bazohet në idenë se gjërat kanë veti të brendshme, dhe ato mund të transmetohen përmes kontaktit. Kështu nxehtësia e zjarrit transmetohet tek çdo gjë që ai prek, dhe disa sëmundje mund të përhapen nga një organizëm në tjetrin. Me apo pa vetëdije, njerëzit në të gjitha kulturat, presin shpesh që llojet e tjera të gjërave mund të transferohen përmes kontaktit.

Për shembull, kjo është arsyeja pse lojtarët në një kazino prekin ndonjëherë dikë që është me fat, për t'u "infektuar" paksa nga fati i tyre. Kjo është edhe arsyeja pse në vitin 2014, një statujë e Zhulietës, personazhit shekspirian që ra çmendurisht në dashuri me Romeon, u zëvendësua për shkak të konsumit të tepërt të shkaktuar nga vizitorët që e preknin për të gjetur dashurinë.

Por këto lloj besëtytnish tradhtojnë diçka më të përgjithshme mbi mënyrën se si mendojnë njerëzit. Për të kuptuar botën tonë, ne kërkojmë modele në natyrë. Kur dy gjëra ndodhin në të njëjtën kohë, ato mund të lidhen midis tyre. Për

shembull, retë e zeza shoqërohen me shiun e rrëmbyer.

Por bota është shumë komplekse. Ndaj në shumicën e kohës, një lidhje nuk nënkupton një shkaktim, edhe pse mund të perceptohet kështu. Nëse vishni një fanellë të re në stadium dhe fiton ekipi juaj, ju mund ta vishni sërish herën tjetër. Nëse ndodh një fitore tjetër e ekipit të zemrës, ju filloni të shihni një model.

Në atë moment, ajo bëhet bluzja juaj me fat. Në realitet, që nga ndeshja e fundit kanë ndryshuar një mori gjërash të tjera. Por ju nuk keni qasje në të gjitha ato gjëra. Ajo që dini me siguri është se keni veshur bluzën e fatit, dhe rezultati ka qenë i favorshëm.

Njerëzit duan që objektet e tyre fat-ndjellëse të funksionojnë. Dhe kur kjo gjë nuk ndodh, ne jemi më pak të motivuar që t'i kujtojmë ato, ose mund t'ia atribuojmë fatin tonë ndonjë faktori tjetër. Nëse skuadra jonë humbet, mund të fajësojmë arbitrin.

Por kur ekipi jonë fiton, kemi më shumë gjasa ta cilësojmë si fat-ndjellëse bluzën që kemi veshur, dhe më shumë gjasa do t'u themi të tjerëve se funksionoi, dhe kjo ndihmon në përhapjen e idesë. Si specie shoqërore, shumë gjëra nga ato që dimë mbi botën vijnë nga

urtësia e përbashkët.

Prandaj është e sigurt të supozohet se nëse njerëzit e tjerë besojnë tek dobia e një veprimi të caktuar, mund të ketë diçka në të. Nëse njerëzit përreth jush thonë se nuk duhet t'i hani ato kërpudha, ndoshta është një ide e mirë që t'i shmangni ato.

Strategji "më mirë diçka e sigurt se diçka e keqe", është një nga arsyet kryesore pse janë kaq të përhapura besëtytnitë. Një arsye tjetër është se ato na bëjnë të ndihemi mirë. Studimet tregojnë se ritualet dhe besëtytnitë shtohen gjatë periudhave të pasigurisë, dhe kryerja e tyre mund të ndihmojë në reduktimin e ankthit dhe rritjen e performancës.

Kur njerëzit ndihen të pafuqishëm, rikthimi tek gjetet e njohura na ofron një ndjenjë kontrolli të situatës, e cila edhe nëse është iluzore, mund të jetë ngushëlluese. Falë këtyre efekteve psikologjike, besëtytnitë kanë ekzistuar prej shekujsh, dhe ka të ngjarë të ekzistojnë edhe në shekujt që do të vijnë.

Shënim: Dimitris Xygalatas, është profesor i asociuar i Antropologjisë dhe Shkencave Psikologjike në Universitetin e Konektikut, SHBA. / "The Conversation" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Brazilia dhe Kroacia kualifikohen në çerekfinale të Kupës së Botës

DOHA, 5 DHJETOR - Brazili bën atë që di të bëjë më mirë, fiton 4-1 ndaj Koresë së Jugut dhe e sheh veten në çerekfinalen e Botërorit të Katarit. Ekipi i Tite do e fillonte me ritëm të frikshëm takimin dhe do gjente golin pas vetëm 7 minutash lojë me Vinicius. Nuk kaloi shumë kohë dhe Seleçiao dyfishuan shifrat, pasi Neymar shndërroi në gol një penallti. Brenda fraksionit, brazilianët do "tundnin rrjetën" edhe dy herë falë Richarlison dhe Paqueta. Me kualifikimin në xhep, pjesa e dytë ishte disi më e qetë dhe më me pak intensitet. Koreanët do luftonin për të shënuar të paktën një gol nderi dhe do ia dilnin mbanë me Paik Seung-Ho. Natë magjike për një nga kombëtaret pretendente të Botërorit, pasi përveç biletës për në fazën tjetër, "fituan" edhe O'Ney, i rikthyer

nga dëmtimi. Brazili do përballet në çerekfinale me Kroacinë. Ndërsa Kroacia shkon në çerekfinale të Kupës së Botës, pasi mori një fitore vetëm falë serisë së penalltive, ndërkohë që koha e rregullt u mbyll në barazim 1-1. Japonzët do të ishin të parët që do shënonin. Në minutën e 43-të, Daizen Maeda përfitoi nga një rrëmujë në zonën e kroatëve, për të shtyrë topin në kuadrat. Kroacia do të reagonte menjëherë në fillimin e pjesës së dytë. Në minutën e 55-të, Ivan Perisiq kërcen mjaft mirë brenda zonës duke shënuar një gol të bukur me kokë. Më pas të dyja skuadrat duket se u pajtuan me këtë rezultat dhe dueli do të shkonte në kohën shtesë. Kjo ishte ndeshja e parë që shkoi në kohën shtesë dhe me penallti në Katar. Në serinë e 11-



metërshave, portieri kroat duke pritur 3 penallti, për t'i kualifikimin, ndërkohë që Livaković dhuron spektakël dhuruar skuadrës së tij Kroacia humbi një penallti.

Përballjet e Superkupës

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Nga 7 deri më 11 dhjetor në Prishtinë do të organizohet Superkupa e Kosovës në basketboll. Në këtë ngjarje të basketbollit do të marrin pjesë tetë klubet e elitës, ku priten përballje interesante. Takimi i parë zhvillohet në mes të kampionit të Kosovës, Golden Eagle Yllit dhe Vëllaznimit, që këtë edicion është rikthyer në elitën e basketbollit. Sfida e dytë e së mërkurës është mes organizatores të kësaj ngjarje, Sigal Prishtinës dhe Ponte

SUPERKUPA E KOSOVËS

T° m'rkur'ën takohen:

(Grupi A-D)
16:00 Çerekfinale 1: Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi
20:00 Çerekfinale 2: Sigal Prishtina - Ponte Prizren

T° enjten takohen:

(Grupi B-C)
17:00 Çerekfinale 3: Trepça - Rahoveci
20:30 Çerekfinale 4: Peja - Bashkimi

T° premtën takohen:

17:00 Gjysmfinale 1 GRUPI A - GRUPI D
20:30 Gjysmfinale 1 GRUPI B - GRUPI C

T° diel'ën takohen:

17:00 Finalja

Prizrenit, që në edicionin e kaluar e fitoi këtë trofe të rëndësishëm për basketbollin e Kosovës. Takime interesante priten edhe të enjten. Trepça dhe Rahoveci është përballja e parë e ditës së enjte, ku sigurisht pritet një ndeshje interesante, kurse takimi i dytë është ndërmjet dy skuadrave me traditë në basketbollin e Kosovës, Peja dhe Bashkimi, që u takuan edhe të dielën (me verdhezinjtë që fituan 71:66). Gjysmëfinalet do të zhvillohen të premtën, ndërsa finalja e madhe të dielën.



Shaqiri: Nuk mund ta shlyeni Ronaldon, ai është një nga më të mirët



Doha, 5 dhjetor - Lojtari i Zvicrës, Xherdan Shaqiri, ka folur për yllin portugez Cristiano Ronaldo. Zviceranët po përgatiten për një përballje të 1/16-tës në Kupën e Botës 2022 me rivalët të mbushur me yje, Portugalinë. Në prag të kësaj përballje, Shaqiri u ka dalë në mbrojtje kritikave për Ronaldon,

duke thënë se është marrëzi të injorohet pesë herë fituesi i "Topit të Artë". "Nuk mund ta shlyeni Cristianon. Ai është një nga lojtarët më të mirë në botë së bashku me (Lionel) Messin. Ky djalë mund të shënojë çdo sekondë, çdo minutë. Ai ka përvojë dhe të gjithë e dinë se sa i rëndësishëm është për

Portgalinë dhe për ekipin e tij", ishin fjalët e tij, sipas "Goal". Shaqiri, gjithashtu, foli edhe për lojtarët e tjerë që, sipas tij, edhe ata mund të bëjnë dallimin. "Duhet t'i njohim edhe lojtarët e tjerë, sepse nuk është vetëm Ronaldo. Ata kanë lojtarë shumë të mirë, lojtarë të rinj që mund të bëjnë një ndryshim të

madh. Ne kemi nevojë për të dhënë një paraqitje vërtet shumë të mirë, sepse është nokaut dhe gjithçka mund të ndodhë në 95-100 minutat dhe ne po e presim me padurim", ka deklaruar Shaqiri. Zvicra do të përballet me Portugalinë të martën, me fillim nga ora 20:00.

FIFA nuk do t'i hetojë Zvicrën dhe Granit Xhakën, Serbinë po

CYRIH, 5 DHJETOR - FIFA të hënën pasdite do t'i nisë procedurat kundër Federatës Serbe të Futbollit. Mediumi zviceran "Blick" shkruan se FIFA ka nisur procedurat pasi mund të ketë

pasur "shkelje të mundshme" të tre neneve të kodit disiplinor të FIFA-s gjatë ndeshjes së Kupës së Botës ndërmjet Serbisë dhe Zvicrës. Këto janë nenet 12, 13 dhe 16. Neni 12 ka të bëjë me

sjelljen e keqe nga lojtarët dhe zyrtarët, neni 13 me diskriminimin dhe neni 16 me sigurinë në lojë. Sipas burime të "Blick", nuk do të ketë asnjë procedim ndaj Zvicrës apo

kapitenit Granit Xhaka. Ndryshe, për këtë ndeshje ka reaguar edhe Federata e Futbollit e Kosovës, ku ka kërkuar sanksione nga FIFA ndaj trajnerit dhe Federatës së Futbollit të Serbisë.



Drita fiton Kupën e Kosovës në volejboll

Gjilan, 5 dhjetor - Drita ka fituar Kupën e Federatës së Volejbollit të Kosovës pas një fitoreje të mundimshme 3-2 (12-25, 25-23, 20-25, 25-23, 18-16) në sete, në një finale spektakolare në "Ilaz Kodra" të Skenderajt. Ishte një fitore e vështirë, por e merituar

për "Intelektualët", të cilët fitojnë trofeun e parë për këtë sezon, derisa mbyllën stinorin vjeshtor si liderë të Superligës A. Me të triumfuar gjilanasit, shpërtheu festa e cila u përcoll me ceremoninë e ndarjes së medaljeve dhe Kupës.

Presidenti i Federatës së Volejbollit të Kosovës, Bahri Gjinovci, ishte ai që ndau Kupën për kapitenin e Dritës. Medaljet për fituesit e Kupës i dhanë nënkryetarja e FVK-së, Mimoza Shkodra dhe sekretari i përgjithshëm, Valon Nikqi.

Medaljet për vendin e dytë u dhanë nga anëtarët e Bordit të FVK-së, Valon Xhafaj dhe komisarët i Garave, Ardian Ibraj. FVK-ja përgëzon Dritën për suksesin e arritur dhe i uron fat në garat e ardhshme Ferizajt dhe ekipeve të tjera pjesëmarrëse.



Sonte zhvillohen dy ndeshje në Ligën Unike të Femrave

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Xhiroja e tretë në Ligën Unike të Femrave do të sjellë disa ndeshje interesante. Takimi i parë i javës do të zhvillohet në mes të Prishtinës dhe Partizanit. Prishtinaset kanë një fitore e një humbje, kurse vashat tiranase kanë dy fitore dhe janë në kërkim të fitores së tretë nga po aq ndeshje. Të dyja skuadrat kanë synime të mëdha në këtë edicion, andaj pritet një përballje interesante. Takimi i dytë do të jetë ndërmjet kampionës së Kosovës, Penzës dhe fituesit të Superkupës së Kosovës, Bashkimit, që nuk ka asnjë humbje në Superligën e Femrave. Të dyja skuadrat kanë

Liga Unike e Femrave

Të martën takohen:

17:00 Prishtina - Partizani
19:00 Penza - Bashkimi

Të enjten takohen:

19:00 Tirana - Flamurtari



dy humbje në ndeshjet e para dhe duan fitoren e parë për këtë edicion. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje është mes dy skuadrave nga Shqipëria, Tiranës dhe Flamurtarit. Skuadra bardheblu

ka një fitore e një humbje, kurse skuadra vlonjate dy fitore në dy ndeshje, ndërsa së fundi fitoi edhe Superkupën Mbarëkombëtare të Ligës Unike, duke treguar qartë për synimet në këtë edicion.

Bostoni dhe Phoenixi kryesojnë konferencat

SAN ANTONIO, 5 DHJETOR - Bostoni rikthehet te fitorja duke mposhtur me rezultat 103-90 Brooklynin, ndeshje e dominuar nga Celticsi. Browni me 34 pikë e 10 rebounde si dhe Tatum me 29 pikë e 11 rebounde bënë dallimin në parket për Bostonin, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Durantit. Zhgënjën Denverin, që u mund me rezultat 121-106 nga New Orleansi, me Alvaradon protagonist, autor i 38 pikëve. Fitorja e tretë radhazi për lakersat që, falë 55 pikëve e 17



Rezultatet

New Orleans - Denver	121-106
San Antonio - Phoenix	95-133
Brooklyn - Boston	90-103
Detroit - Memphis	112-122
New York - Cleveland	92-81
Washington - Lakers	119-130
Sacramento - Chicago	110-101
Portland - Indiana	116-100

reboundeve të Anthony Davisit, mundi me rezultat 130-119 Washingtonin. Phoenixi vijon të jetë lider në Perëndim, duke fituar me rezultat 133-95 ndaj San Antonios. Ayton me 25 pikë si dhe Bookerit e Bridgesit me nga 20 pikë secili u dalluan për Suns-in. Sacramento mposhti Chicagon (110-101), ndeshje ku spikati Monk me 20 pikë.

SHKURT

'Marca': Ronaldo në janar kalon tek Al-Nassr

Ylli i Portugalisë, Cristiano Ronaldo, pritet të luajë për Al-Nassr nga 1 janari. Kontrata që bashkon futbollistin portugez me skuadrën saudite do të zgjasë për dy sezone e gjysmë, siç u njoftua javën e kaluar. Sulmuesi i dha fund lidhjes me Manchester Unitedin dy ditë para se të niste pjesëmarrja në Botërorin e Katarit, duke qenë në gjendje të negocionte me çdo skuadër, ku Al-Nassr ishte ai që shfaqti më shumë interes që në fillim, raporton "Marca". Kontrata, përveç shumës së madhe (pak më pak se njëqind milionë euro), është e rrethuar nga stimuj ekonomikë nëpërmjet reklamave, të cilat do ta vendosin portugezin si atletin më të paguar në botë. Numri total i lidhjes së CR7 me Al-Nassr do të jetë afër 200 milionë euro në sezon. Messi, Neymar te PSG janë kryesuesit e posterit të futbollit, por 75 dhe 70 milionët e tyre që fitojnë në sezon janë shumë larg asaj që do të marrë Cristiano Ronaldo në Arabinë Saudite. Edhe duke rishikuar listën e më të paguarve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të gjithë mbeten shumë larg parave të premtuara për portugezin.

Arsenali interesohet për Sanen

Lëndimi i sulmuesit Gabriel Jesus ka bërë që Arsenali të përforcohet në afatin kalimtar të janarit. Sipas gazetarit Pete O'Rourke (i cili dha një intervistë për GIVEMESPORT), Arsenali është i interesuar për mundësinë e transferimit të sulmuesit anësor të Bayern Munchenit dhe Gjermanisë, Leroy Sane. Sane për momentin nuk dëshiron të largohet nga Bayern Munchen për shkak se është titullar vazhdimisht nën urdhrat e trajnerit Julian Nagelsmann. Megjithatë, sipas O'Rourke, lidhja e tij me Arsenalin përmes Mikel Artetas, Gabriel Jesusin dhe Oleksandr Zinchenkon, do të bënte që ai ta merrte në konsideratë një kalim te liderët e Premierë Ligës.

Dechamps: Sa mirë që e kemi në skuadër Mbappen

Trajneri Didier Dechamps e lavdëroi sulmuesin Kylian Mbappe për kualifikimin e Francës në çerekfinale të Kupës së Botës. Ai ka thënë se Mbappe ka aftësi të mëdha për të zgjidhur çdo problem. "Nuk ishte e lehtë sepse skuadra polake ishte e organizuar dhe gati për të dyluftuar ndaj nesh, por u treguam të aftë për ta mundur. Pastaj është Kylian, i cili ka aftësitë për të zgjidhur çdo problem. Sa mirë që e kemi në skuadër. Rezultati 3-1 është fryt i punës së madhe që kemi zhvilluar dhe i unitetit të grupit. Është me të vërtetë një gëzim i përbashkët. Tani është koha për të kaluar disa momente me familjarët dhe të dashurit tanë", ka thënë Dechamps.

Mourinho e dëshiron Depayn në Romë

AS Roma dhe trajneri Jose Mourinho kanë treguar interesim për sulmuesin e Holandës, Memphis Depay. Ky i fundit po shkëlqen në Kupën e Botës, por në skuadrën e Barcelonës nuk po ka hapësirat e mundshme. Jose Mourinho po interesohet për ta marrë sulmuesin në formë huazimi deri në muajin qershor, kurse më pas të nënshkruajë një kontratë afatgjatë.

Felix në shitje, Atletico kërkon 100 milionë euro

Futbollisti Joao Felix është në Kupën e Botës me Portugalinë, por duket se nuk do të rikthehet më në Atletico Madrid. Sulmuesi nuk është

aspak i lumtur te skuadra spanjolle, pasi nuk po luan rregullisht dhe nuk po i pëlqen stili i lojës që po e aplikon trajneri Diego

Simeone. Felix ka kërkuar largimin nga Atletico dhe duket se dëshira e tij do të bëhet realitet qysh në afatin kalimtar të janarit. "Marca" ka

raportuar se "Los Colchoneros" është i gatshëm ta shesë yllin portugez, por do që të fitojë mbi 100 milionë euro nga largimi i tij.

Manchester Unitedi, Chelsea, Bayern Muncheni e Paris Saint Germaini janë skuadrat e interesuara për shërbimet e tij.



Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), nenit 15 paragrafi 15.2 pika 15.2.5 të Statuti i Ndërmarrjes Publike Komunale "Trafiku Urban" – SHA. Bordi i Drejtorëve i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A., në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **30/11/2022** mori vendim që të shpall:

KONKURS

Kryeshef Ekzekutiv në ndërmarrjen N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A Prishtinë

Të përgjithshme

Kandidati për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili i plotëson kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të ketë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv

Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 3 (tre) vjetëve, me mundësi të vazhdimit edhe për një mandat.

Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv

Kompensimi dhe përfitimet e Kryeshefit Ekzekutiv do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve në N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A., në përputhje me rregulloren e brendshme për paga të ndërmarrjes.

Përshkrimi i punëve

Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A në Prishtinë, krahas punëve të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi

- Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes ka autoritet që të lidhë kontratë për ndërmarrjen, në pajtueshmëri me Ligjin, Statutin dhe Kontratën e Punës, si dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e nenit 192, paragrafi 192.1, pika c, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- Kryeshefi Ekzekutiv vepron si zyrtar kryesor administrativ i ndërmarrjes;
- Organizimi i Ndërmarrjes bëhet në mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Kryeshefit Ekzekutiv në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të ndërmarrjes dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve;
- Të gjitha çështjet në lidhje me ndërmarrjen të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit Komunal të Aksionareve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit/Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, do të vendosen me përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv;
- Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë autoritet të punësojë apo të largojë nga puna zyrtarët dhe stafin e ndërmarrjes përveç zyrtarëve të cilët zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve apo Komisioni i Auditimit;
- Merr pjesë me Bordin e Drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe planet e saja strategjike afatgjata;
- Ofron kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në muaj, Bordit të drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti lidhur me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;
- Nën përgjegjësinë e tij Bordit të Drejtorëve i dorëzon dokumente, shkresa dhe informacione lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
- Bën matjen e performancës së ndërmarrjes dhe i ofron Bordit të Drejtorëve rregullisht së paku çdo tre apo gjashtë muaj raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes, ndaj klientëve të saj;
- Ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
- Ofron Zyrtarit të Auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohen nga ai;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme;
- Kryen detyra dhe punë të tjera të caktuara nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Për punën e tij/saj i raporton Bordit të Drejtorëve.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Diplomë Universitare, së paku 240 ECTS në fushat të ndërlidhura me aktivitetet me të cilat vepron Ndërmarrja. Përmblotë kushtet dhe kualifikimet sipas legjislacionit në fuqi;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë në menaxhim të lartë (pozita të larta drejtuese);
- Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohuri në gjuhën angleze e preferuar.

Informatë për procedurën e konkurrimit

- Kandidati duhet t'i dorëzojë dokumente në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban vetëm në zarfë të mbyllur;
- Aplikacionin;
- CV-në;
- Letër motivimin;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Listën kontrolluese për aplikacionin, të plotësuar.
- Deklaratën nën betim



Aplikanti duhet ta vendosë nënshkrimin, datën si dhe deklaratën nën betim ku deklorohet që i përmblotë të gjitha kushtet e pranueshmërisë. Kjo deklaratë bashkë me listën kontrolluese për aplikacionin mund të shkarkohen nga webfaqja e Ndërmarrjes N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. në Prishtinë <http://www.trafikurban-pr.com>

Aplikacionet së bashku me deklaratën nën betim merret në adresën elektronike të N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. zyrtar: info@trafikurban-pr.com

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura të aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën.

Çdo përgjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë me diskualifikimin menjëhershëm.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe inkurajon të gjitha femrat e meshkujt e të gjitha komuniteteve që i plotësojnë kriteret e konkursit që të aplikojnë.

Ky proces i rekrutimit do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit Britanik dhe Shoqëria Civile për rekrutim dhe pozita në larta, sipas vullnetit të tyre. Kandidatët njoftohen se emrat, notimi dhe emërimi i kandidatëve me notimin më të lartë në këtë konkurs mund të publikohet në faqen e këtij projekti dhe në faqen e N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A në internet dhe se me aplikimin për këtë pozitë do të konsiderohet se ata e kanë dhënë pëlqimin për publikimin në fjalë.

Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Bordi i Drejtorëve i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. e mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikantët si dhe përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban në orarin administrativ.

Konkursi është i hapur nga data 06.12.2022 dhe përfundon më datë 20.12.2022 në ora 16:00

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

3

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Petrit Rakoci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Auto Mekanik.

- Hekuran Krasniqi nga Demjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. kongresi manastirit Demjan KK Gjakovë nga kl. I-V dhe nga kl. VI-IX.

- Kujtese Kokalla nga Cermjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Amet Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

- Kastriot Mucaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Elvis Susuri shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Eldina Bajcini shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Burim Fazliu (Krasniqi) shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

- Andi Shefqeti shpall te pavlefshme diplomën dhe vërtetimin e lëshuar për gjendjen e notave dhe mungesave shmt "11 Marsi " Prizren.

- Redon Mazreku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Edison Mazreku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Albnor Ibrahim shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren

- Albina Dumnica B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330445842.

- Agron Merovci nga Vushtrria shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Bujqësore tash "Avdyl Frashëri" drejtimi Veterinë.

- Sahit Kurhasku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Ali M. Hasi" Crmjan KK Gjakovë nga kl.I-VII.

- Avdullah Guta nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.



Na osnovu odredaba člana 21. Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća ("Službeni list Republike Kosovo", br. 31/15 jun 2008), odnosno član 13 Zakona br. 04/L-111 za izmenu i dopunu zakona br. 03/L-087 za Javna preduzeća (Službeni list Republike Kosovo" br. 13/30. maj 2012), član 15 stav 15.2 tačka 15.2.5 Statuta Opštinskog javnog preduzeća "Trafiku Urban" SHA. Upravni odbor N.P.K. "Trafiku Urban" SHA., u Prištini, na sednici održanoj: 30.11.2022.godine, odlučio je da saopšti:

KONKURS

Izvršni Direktor kompanije N.P.K. "Trafiku Urban" SHA Priština

General

Kandidat za ovo radno mesto mora biti pošteno lice, koje ispunjava uslove kvalifikacije, kriterijume nezavisnosti, mora imati potrebno stručno iskustvo i traženu stručnu spremu i druge uslove propisane odredbama Zakona o javnim preduzećima.

Mandat Glavnog Izvršnog direktora

Izvršnog Direktora imenuje Upravni Odbor na period od 3 (tri) godine, sa mogućnošću produženja za još jedan mandat.

Kompenzacija Glavnog Izvršnog direktora

Naknade i beneficije glavnog Izvršnog Direktora utvrdiće Upravni odbor N.P.K. "Trafiku Urban" SHA. u skladu sa internim pravilnikom o zaradama preduzeća.

Opis radova

Glavni Izvršni direktor N.P.K. "Trafiku Urban" SHA. u Prištini, pored poslova predviđenih odredbama Zakona br. 02/L-123 o privrednim društvima i Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, postoje i ove dužnosti i odgovornosti.

- Izvršni Direktor preduzeća je ovlašćen da zaključi ugovor za preduzeće, u skladu sa Zakonom, Statutom i Ugovorom o radu, kao i drugim aktima o radu, osim u slučajevima predviđenim odredbama čl. 192, stav 192.1, tačka c, Zakona o privrednim društvima;
- Glavni Izvršni službenik deluje kao glavni administrativni službenik preduzeća;
- Organizacija preduzeća je pod nadzorom i odgovornošću glavnog Izvršnog Direktora u skladu sa statutom i drugim aktima preduzeća i odlukama odbora Direktori;
- O svim pitanjima u vezi sa preduzećem koja nisu u nadležnosti Opštinskog odbora akcionara, Upravnog Odbora, Komisije za reviziju/Službenika za unutrašnju reviziju, odlučivaće odgovornosti glavnog izvršnog službenika;
- Glavni Izvršni direktor će imati ovlašćenje da zapošljava ili otpušta službenike i osoblje kompanije, osim zvaničnika koje bira Upravni odbor ili Komisija za reviziju;
- Učestvuje sa Upravnim Odborom u definisanju strategije društva i njegovih dugoročnih strateških planova;

- Obezbeđuje, kad god je potrebno, a najmanje jednom mesečno, izveštaje Upravnom odboru o glavnim transakcijama koje je preduzelo društvo i o glavnim odlukama koje je doneo menadžment u vezi sa vođenjem delatnosti društva;
- Pod svojom odgovornošću podnosi Upravnom odboru dokumenta, pisma i informacije u vezi sa svim pitanjima koja su uključena u dnevni red njegovih sednica;
- Mjeri učinak kompanije i dostavlja Upravnom odboru redovno najmanje svaka tri ili šest mjeseci izvještaje o mjerenju učinka kompanije svojim klijentima;
- Pruža Komitetu za reviziju sve informacije i pomoć koja može biti potrebna;
- Pruža službeniku za unutrašnju reviziju sve informacije i pomoć koja se može tražiti od njega;
- Učestvuje na svim opštim sastancima;
- Obavlja poslove i druge poslove koje mu odredi Upravni odbor u skladu sa važećom zakonskom regulativom;
- Izvještava o svom radu Upravnom odboru.

Kvalifikacije i stručna obuka

- Visoka stručna sprema, najmanje 240 ESPB iz oblasti koje se odnose na delatnost kojom Društvo posluje. Ispunjava uslove i kvalifikacije u skladu sa zakonima na snazi;
- Imati najmanje 5 godina iskustva u višem rukovodstvu (više rukovodne pozicije);
- Da poseduje organizacione sposobnosti, liderstvo i odlične komunikacijske veštine;
- Dokazane veštine u radu sa grupama i organizacijom preduzeća ili slično;
- Dobro poznavanje rada na računaru;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

Informacije o konkursnoj proceduri

- Kandidat mora dostaviti dokumenta u fizičkom obliku u kancelariju broj 5 Gradskog saobraćaja samo u zatvorenoj koverti:
- Aplikacija;
- SI-VI;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Uverenje koje nije pod istragom (ne starije od šest meseci);
- Kopija lične karte;
- Kontrolna lista za aplikaciju, popunjena.
- Izjava pod zakletvom

Podnosilac prijave mora potpisati, datirati i dati izjavu kojom izjavljuje da ispunjava sve uslove podobnosti. Ova izjava zajedno sa kontrolnom listom za prijavu može se preuzeti sa veb stranice preduzeća N.P.K. "Trafiku Urban" SHA. u Prištini <http://www.trafikurban-pr.com>

Prijave uz izjavu pod zakletvom primaju se na elektronsku adresu N.P.K. "Trafiku Urban" SHA. službeno: info@trafikurban-pr.com

Naziv radnog mesta mora biti jasno naveden u prijavi, a dokumenti priloženi uz prijavu moraju biti kopije i ne vraćaju se. Prijave podnete nakon isteka roka se ne prihvataju, a nepotpune prijave se odbijaju.

Kandidati koji konkurišu moraju tačno da unesu adresu i kontakt telefon, kao i mejl adresu.

Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

N.P.K. "Trafiku Urban" SHA. Priština nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo i podstiče sve žene i muškarce iz svih zajednica koji ispunjavaju kriterijume konkursa da se prijave.

Ovaj proces zapošljavanja će pratiti predstavnici Britanskog projekta i Civilnog društva za zapošljavanje i rukovodeće pozicije, prema njihovoj volji. Obavještavaju se kandidati da se imena, rejting i imenovanje kandidata sa najvećim rejtingom na ovom konkursu mogu objaviti na sajtu ovog projekta i na sajtu N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A online i da će se prijavom na ovu poziciju smatrati da su dali saglasnost na predmetnu publikaciju.

Formalna procena kandidata i intervjui će se obaviti u optimalno vreme nakon roka za prijavu. Upravni odbor N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. zadržava pravo formiranja uže liste kandidata kao i izbora glavnog izvršnog direktora.

Način primene:

Prijava se može podneti samo u fizičkom obliku u kancelariji 5 Gradskog saobraćaja u administrativno vreme.

Konkurs je otvoren od 06.12.2022 i završava se 20.12.2022 u 16:00 časova.

NPK " Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

3

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Exillent" SH.P.K. me pronar Bajram Kovaqi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810127458 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Exillent" D.O.O. Bajram Kovaqi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810127458 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Exillent" L.L.C. Bajram Kovaqi, has come to the decision to quit its business: 810127458 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

